



REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI

Kryetari

Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 dhe nenin 67 "f" dhe "g" të Statutit të Komunës, si dhe në bazë të propozimit të Drejtorisë për Mbrojtje dhe Shpëtim ref. 34/2018, datë 07.03.2018, Kryetari i Komunës merr këtë:

### V E N D I M PËR FORMIM TË KOMISIONIT

1. Formohet komisioni për vlerësim të dëmeve nga vërshimet e lumenjve në Komunën e Vushtrrisë në këtë përbërje:
  - 1.1 **Bajram Beqiri**, DMSH - kryesues i komisionit,
  - 1.2 **Mexhit Perçuku**, DEBPZHR - anëtar,
  - 1.3 **Ymer Cecelia**, DSHP - anëtar,
  - 1.4 **Egzon Haradinaj**, DUMM – anëtar,
  - 1.5 **Velibor Savic**, ZLK – anëtar
2. Komisioni në përbërje të cekur si në pikën paraprake do të bëjë evidentimin e sipërfaqeve të tokës bujqësore dhe hapësirave të banimit të vërshuara, dëmeve të shkaktuara nga vërshimet e ditëve të fundit në Komunën e Vushtrrisë si dhe bëjë vlerësimin e atyre dëmeve sipas lokaliteteve dhe në total.
3. Komisioni, për punën e tij do të hartoj raport me shkrim për kryetarin e komunës dhe organet tjera kompetente sipas nevojës.
4. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.
5. Vendimi i dërgohet: Drejtorisë për Ekonomi bujqësi Pylltari dhe Zhvillim Rural, Anëtarëve të Komisionit dhe Arkivit të Sekretarisë.



Kryetari i Komunës

Xhafer Tahiri



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO  
KOMUNA E VUSHTRRISË - OPSTINA VUČITRN

03 Nr./Br. 303/18

No. l.fq./Bost. \_\_\_\_\_

Datar / Datum 08.03.2018

VUŠITRRI - VUČITRN



REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI

Kryetari

Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, nenin 67 “g” të Statutit të Komunës, si dhe në bazë të propozimit nr. 46/2018, datë 07 mars 2018 të Drejtorisë për Kulturë Rini dhe Sport, Kryetari i Komunës merr këtë:


### V E N D I M

1. OJQ “Lëvizja Koha” nga Mitrovica i ndahen mjete financiare në shumë prej 380.00 € (treqind etetëdhjetë euro) nga buxheti i Komunës, njësia buxhetore – Drejtoria për Kulturë Rini dhe Sport, kategoria subvencione dhe transfere – për organizim të aktiviteteve me rastin e 8 marsit – Ditës Ndërkombëtare të Gruas.
2. Drejtoria për Kulturë Rini dhe Sport duhet të lidhë marrëveshje mirëkuptimi me përfituesin e mjeteve për mënyrën dhe kushtet e shfrytëzimit të mjeteve nga pika 1 (një) e këtij vendimi.
3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen Drejtoria për Kulturë Rini dhe Sport dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa.
4. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.
5. Vendimi i dërgohet: Drejtorisë për Kulturë Rini dhe Sport, Drejtorisë për Buxhet dhe Financa dhe Arkivit të Sekretarisë.



Kryetari i Komunës

Xhafer Tahiri



REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI  
Kryetari

Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 dhe nenin 67 “f” dhe “g” të Statutit të Komunës, Kryetari i Komunës merr këtë:


**V E N D I M**  
**PËR FORMIM TË GRUPIT PUNUES**

1. Formohet grupi punues për kodin e etikës komunale në Komunën e Vushtrrisë në këtë përbërje:
  - 1.1 **Lutfi Gërguri** Drejtor i Buxhetit dhe Financave
  - 1.2 **Mehmet Selaci**, Drejtor për Administratë,
  - 1.3 **Idriz Muzaqi**, Udhëheqës i Zyrës Ligjore,
  - 1.4 **Bislim Dushi**, Udhëheqës i Personelit,
  - 1.5 **Fadil Bahtiri**, Zyrtar për Protokoll në Kabinetin e Kryetarit
2. Grupi punues në përbërje të cekur si në pikën paraprake do të zhvillojë aktivitetin që ndërlidhet me “Kodin e Etikës” komunale dhe zbatimin në praktikë të këtij mekanizmi me rëndësi. Në kuadër të këtij aktiviteti USAID-i do të organizoj trajnim një ditorë që do të mbahet në Prishtinë me 30 Mars 2018, në Hotel Emerald ku do të marrin pjesë edhe përfaqësuesit e Ministrisë së Financave - Njësia Qendrore e Harmonizimit.
3. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.
4. Vendimi i dërgohet: anëtarëve të grupit punues dhe Arkivit të Sekretarisë.



Kryetari i Komunës

Xhafer Tahiri



REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI  
Kryetari

Në pajtim me pikën 7.1 nënpika 3 të Strategjisë për Përfshirjen e Komuniteteve Rom dhe Ashkali në Shoqërinë Kosovare (2017-2021) prill 2017 dhe pikën 4.1, 4.2 dhe 4.3 të Mekanizmit Koordinues për Zbatimin e Strategjisë dhe Planit të Veprimit për Përfshirjen e Komuniteteve Rom dhe Ashkali në Shoqërinë Kosovare (2017-2021) shtator 2017 të Qeverisë së Republikës së Kosovës – Zyra për Qeverisje të mirë, Kryetari i Komunës shpall:

### K O N K U R S

Për pranim të anëtarëve nga OJQ-të lokale dhe ndërkombëtare në Komitetin Komunal Veprues

#### Nr. i anëtarëve të Komitetit komunal veprues (KKV) të kërkuar :

- Nga OJQ të komunës – 2 (dy) anëtarë
- Nga OJQ ndërkombëtare – 2 (dy) anëtarë

#### Detyrat dhe përgjegjësitë e KKV:

- Në bashkëpunim me OJQ-të përkatësisht shoqërinë civile dhe autoritetet e komunës të inicoj hartimin e planit komunal të veprimit për përfshirjen e komuniteteve Rom dhe Ashkali në shoqërinë Kosovare (2017-2021),
- Të inicoj miratimin e politikave tjera lokale që kontribuojnë në zbatimin e objektivave të parapara në kuadër të planit komunal të veprimit për përfshirjen e komuniteteve Rom dhe Ashkali në shoqërinë Kosovare (2017-2021),
- Të koordinoj aktivitetet brenda komunës për monitorimin e zbatimit të Strategjisë dhe Planit të Veprimit për Përfshirjen e Komuniteteve Rom dhe Ashkali në Shoqërinë Kosovare (2017-2021),
- Monitorimin e fondeve të ndara nga buxheti i komunës në raport me burimet e nevojshme financiare për zbatimin e aktiviteteve të përcaktuara në dokumentin e planit të veprimit,
- Në bashkëpunim me Zyrën e Kryeministrit – Zyra për Qeverisje të mirë, të ndërtoj instrumentet/format e mbledhjes së të dhënave dhe raportimit mbi zbatimin e strategjisë,
- Të mbledhë dhe analizoj të dhënat e drejtorive komunale për masat e ndërmarrura në kuadër të strategjisë,
- Të raportoj tek Zyra e Kryeministrit – Zyra për Qeverisje të mirë në baza 6 mujore dhe vjetore për të arriturat në zbatimin e strategjisë,
- Të dërgoj tek Zyra e Kryeministrit – Zyra për Qeverisje të mirë procesverbalet e takimeve të KKV-ve,
- Të propozoj masa shtesë para drejtorive komunale me qëllim të përmbushjes së obligimeve që dalin nga strategjia,

- Të propozoj tek partnerët ndërkombëtarë aktivitete të planit ë veprimit të cilat nuk mbulohen nga buxheti i komunës e që mund të jenë në sferën e interesit të tyre dhe që kërkojnë mbështetjen e tyre financiare,
- Të shërbej si një platformë për shkëmbim të informatave ndërmjet drejtorive komunale , zyrave, organizatave ndërkombëtare dhe organizatave tjera jo qeveritare,
- Të shfrytëzoj takimet e rregullta si një forum për shkëmbimin e rezultateve mësimore të nxjerra dhe praktikave më të mira,
- Në vitin e fundit të zbatimit të planit komunal të veprimit për përfshirjen e komuniteteve Rom dhe Ashkali në shoqërinë Kosovare (2017-2021) duhet të bëj vlerësimin e përmbushjes së objektivave të parapara me planin e veprimit.

#### **Kushtet:**

- OJQ lokale dhe ndërkombëtare, duhet të ken zhvilluar aktivitetin e tyre në programe që kanë për qëllim avancimin e pozitës së pjestarëve të komunitetit Rom dhe Ashkali,
- OJQ duhet të jetë aktive në Komunë për të paktën tre vitet e fundit,
- Të jetë organizatë kredibile dhe profesionale,
- Të ketë performancë të knaqshme përsa i përket avancimit të rolit të komunitetit Rom dhe Ashkali në integrimin e tyre në shoqëri.

#### **Mandati:**

Mandati i anëtarëve të Komitetit Komunal Veprues është i njejtë me kohëzgjatjen e zbatimit të Strategjisë 2017-2021.

Përzgjedhja e përfaqësuesve të OJQ-ve do të bëhet nga komisioni prej tre anëtarësh i themeluar nga Kryetari i Komunës.

Konkursi mbetet i hapur 15 dite nga dita e shpalljes në mjetet e informimit publik.

#### **Dokumentet e kërkuara:**


Dëshminë për regjistrim të organizatës (OJQ-së) dhe akteve tjera valide për themelim të OJQ-së si dhe dëshminë për autorizim nga OJQ-ja, të përfaqësuesit të tyre për të aplikuar në konkurs për përzgjedhje në Komitetin Komunal Veprues.

Kërkesa për aplikim me dokumentet e kërkuara mund të dorëzohen çdo dite pune prej orës 08:30 deri ne oren 15:30 ne Zyren e Pranimi te Komunes se Vushtrrise.



Kryetari i Komunës

Xhafer Tahiri



## REPUBLIC OF KOSOVO – VUSHTRRI MUNICIPALITY

### MAJOR

Pursuant to point 7.1 sub-paragraph 3 of the Strategy for the Inclusion of Roma and Ashkali Communities in Kosovo Society (2017-2021) April 2017 and points 4.1, 4.2 and 4.3 of the Coordination Mechanism for the Implementation of the Strategy and Action Plan for the Inclusion of Roma Communities and Ashkali in Kosovo Society (2017-2021) September 2017, the Government of the Republic of Kosovo - Office for Good Governance, the Mayor announces:

#### ANNOUNCEMENT

For the for acceptance of members from local and international NGOs to the Municipal Action Committee

#### **Nr. of the members of the Municipal Operating Committee (MCC) required:**

- From municipal NGOs - 2 (two) members
- From international NGOs - 2 (two) members

#### **Duties and responsibilities of MCC:**

- In cooperation with NGOs, respectively with civil society and municipal authorities, to initiate a draft municipal action plan for the inclusion of Roma and Ashkali communities in Kosovo society (2017-2021)
- To initiate the approval of other local policies that contributes in implementation of the objectives set out in the Municipal Action Plan for the Inclusion of Roma and Ashkali Communities in Kosovo Society (2017-2021)
- To Coordinate activities within the municipality, to monitor the implementation of the Strategy and Action Plan for the Inclusion of Roma and Ashkali Communities in Kosovo Society (2017-2021)
- Monitoring of funds allocated from the municipal budget in relation to the necessary financial resources for the implementation of the activities set out in the action plan document.
- In cooperation with the Office of Prime Minister - Office of Good Governance, build tools / forms of data collection and reporting on the implementation of the strategy.
- Collect and analyze the data of municipal directorates on the measures taken under the strategy.
- Report to the Office of the Prime Minister - the Office for Good Governance on 6 monthly based and Annual basis for achievement in the implementation of the Strategy.
- To send to the Office of the Prime Minister - Good Governance Office minutes of meetings of MCC s,
- To propose additional measures to the municipal directorates in order to fulfill the obligations deriving from the strategy,

- To propose to international partners activities of the action plan that are not covered by the municipal budget which may be in the sphere of their interest and which require their financial support.
- Serve as a platform for exchanging information between municipal directorates, offices, international organizations and other non-governmental organizations.
- Use regular meetings as a forum for sharing results of lessons learned and best practices.
- In the last year of implementation of the municipal action plan for the inclusion of Roma and Ashkali communities in Kosovo society (2017-2021), it is necessary to evaluate the fulfillment of the objectives set out in the action plan.

**Terms:**

- Local and international NGOs should have developed their activities in programs aimed at advancing the position of Roma and Ashkali community members.
- NGOs should be active in the Municipality for at least three years.
- To be a credible and professional organization,
- To have satisfactory performance in terms of advancing the role of Roma and Ashkali communities in their integration into society.

**Mandate:**

The mandate of the members of the Municipal Action Committee is the same as the duration of the implementation of the 2017-2021 Strategy.

The selection of NGO representatives will be made by a three-member committee established by the Mayor of the Municipality.

The advertisement remains open 15 days from the day of announcement in the public media.

**Required Documents:**


Evidence of the registration of organizations (NGOs) and other valid acts for the establishment of NGOs, as well as evidence of authorization by NGOs for their representatives to apply for selection in the Municipal Action Committee.

The application form with the required documents can be submitted every working day from 08:30 to 15:30 at the Reception Office of the Municipality of Vushtrri.



Mayor of the Municipality

Xhafer Tahiri



REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI  
REPUBLIKA KOSOVA - OPŠTINA VUČITRN

Predsednik

U skladu sa tačkom 7.1 podtačka 3 Strategije za Uključenje Romske i Aškalijske zajednice u Kosovsko društvo (2017-2021) aprila 2017god i tačka 4.1, 4.2 i 4.3 Koordinacionog Mehanizma za Sprovođenje Strategije i Plana Delatnosti u Uključivanju Romske i Aškalijske zajednice U Kosovskom društvu (2017-2021) septembra 2017 god, Vlade Republike Kosova – Kancelarija za dobro upravljanje ,Predsednik Opštine objavljuje :

### KONKURS

Za prijem članova iz lokalne i međunarodne NVO u Opštinskom odboru za delovanje

#### **Br. Članova u Opštinskom odboru za akciju (SOV) :**

- Od strane opštine NVO – 2 (dva ) člana
- Od strane međunarodne NVO – 2 (dva ) člana

#### **Zadaci i odgovornosti SOV:**

- U saradnji sa NVO- odnosno civilnim društvom i opštinske vlasti da iniciraju izradu opštinskog akcionog plana za uključivanje Romske i Aškalijske zajednice u Kosovskom društvu (2017-2021 god),
- Inicirati usvajanje drugih lokalnih politika koja doprinesu u sprovođenju predviđenih objekta u okviru opštinskog akcionog plana za uključivanje Romske i Aškalijske zajednice u Kosovskom društvu (2017-2021 god),
- Koordinirati aktivnost unutar opštine za praćenje sprovođenja Strategije i Akcionog Plana za uključivanje Romske i Aškalijske zajednice u Kosovskom društvu(2017-2021 god),
- Praćenje sredstava odvojeni iz opštinskog budžeta u izveštaju sa potrebnim finansijskom izvorima za sprovođenje utvrđenih aktivnosti na dokumentu plana delatnosti ,
- U saradnji sa Kancelarijom Premijera – Kancelarija za dobro upravljanje , da izgradi instrumenta/ oblike prikupljanja podataka i izveštavanja o sprovođenju strategije ,
- Prikupti i analizirati podatke opštinskih uprava za preduzete mere u okviru strategije,
- Izveštava u Kancelariji Premijera Kancelarija za Dobro upravljanje na šestomesečnoj i godišnjoj osnovi za postignuća u sprovođenju strategije,
- Dostaviti u Kancelariji Premijera – Kancelarija za Dobro upravljanje zapisnike sa sednice SOV,
- Predložiti dodatne mere ispred opštinskih uprava u cilju ispunjavanja obaveza koja proizlazu is strategije,



- Predložiti u međunarodne partnere aktivnosti akcionog plana koji se ne pokrivaju od budžeta opštine koja mogu biti u oblasti njihovih interesa i koja traže njihovu finansijsku podršku ,
- Služiti kao jedna platforma za razmenu informacija između opštinskih uprava , kancelarija , međunarodnih organizacija i druge nevladine organizacije ,
- Koristiti redovne sastanke kao jedan forum za razmenu rezultata naučenih lekcija i bolje prakse,
- U poslednoj godini implemmentacije akcionog plana opštine za uključivanje Romske i Aškalijske zajednice u drušvu Kosova (2017-2021god) mora obavljati procenu ispunjavanja predviđenih objekta saakcionim planom .

#### **Uslove:**

- Lokalne i međunarodne NVO,moraju imati njihovu razvijenu aktivnost u programima koja imaju za cilj avansiranje pozicije učesnika Romske i Aškalijske zajednice,
- NVO moraju biti aktivne u Opštini najmanje tri poslednih godina ,
- Biti kredibilna i stručna organizacija ,
- Imati zadovoljavajuće performanse što se tiče avansiranja uloge Romske i Aškalijske zajednice u njihovoj integraciji u društvo.

#### **Mandat:**

Mandat članova Opštinskog odbora za delovanje je ista sa vremenom trajanja Strategije 2017-2021 god.

Izbor predstavnika NVO-a će biti od strane komisije od tri člana osnovana od Predsednika Opštine.

Konkurs ostaje otvoren 15 dana od dana objavljivanja u sredstvima javnog informisanja .

#### **Potrebne dokumente:**

Dokaz o registraciji organizacije (NVO-a) i drugih važećih akata za osnivanje NVO-a, kao dokaz o ovlašćenju od NVO-a, njihovih predstavnika da bi aplicirali na konkursu za izbor u Opštinskom Akcionom odboru.

Zahtev za apliciranje sa potrebnim dokumentima mogu se predati svakog radnog dana od 08:30 do 15:30 časova, u Prijemnoj Kancelariji Opštine Vučitrn .


  
**Predsednik Opštine**  
**Xhafer Tahiri**

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO  
KOMUNA E VUSHTRRIË - OPŠTINA VUÇITRAN

02 Nr. / Br 328 / 18

Nr. i fq. / Br. sht \_\_\_\_\_

Data: / Datum 14.03.2018

VUSHTRRI - VUÇITRAN



REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI

Kryetari



Bazuar në nenin 13 dhe nenin 58 pika b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, dhe nenin 12 pika 4 të Ligjit për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës nr.03/L-149, Kryetari i Komunës merr këtë:

#### V E N D I M

Për formimin e komisionit për shqyrtimin e kërkesave dhe nevojave të organeve të administratës komunale në Vushtri, për angazhimin e stafit me marrëveshje për shërbime të veçanta.

Komisioni ka këtë përbërje:

1. Lutfi Gërguri, Drejtor i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, kryesues i komisionit
2. Afrim Namani, Drejtor i Drejtorisë për Arsim, anëtar i komisionit
3. Mehmet Selaci, Drejtor i Drejtorisë për Administratë, anëtar i komisionit
4. Bislim Dushi, Udhëheqës i Personelit, anëtar i komisionit.

Komisioni ka për obligim të shqyrtojë kërkesat dhe të përgatitë raport me shkrim.

Vendimi hynë në fuqi ditën e nënshkrimit.

Kryetari i Komunës  
  
Xhafer Tahiri





REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO  
KOMUNA E VUSHTRRISE - OPŠTINA VUČITRN  
02 Nr / Nr. 378 / 18  
Nr. i list. / list. \_\_\_\_\_  
Data: / Datum. 20. 03. 2018  
VUSHTRRI - VUČITRN




REPUBLICA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI

Kryetari

Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 dhe nenin 67 "g" të Statutit të Komunës, Kryetari i Komunës jep këtë:

### URDHËRESË

1. Urdhërohen të gjithë drejtorët e drejtorive që materialet të cilat i përgatisin për Komitetin për Politikë dhe Financa dhe Kuvendin e Komunës, duhet të i dorëzojnë në Sekretarinë e KK-së më së largu deri me datën 05 të secilit muaj gjatë vitit kalendarik.
2. Materialet të cilat arrijnë në sekretari pas datës së cekur në pikën paraprake nuk do të vihen në rend të ditës në mbledhjet e KPF-së dhe KK-së të atij muaji. Në këtë rast, përgjegjësinë për vonesë të materialeve do ta bartë drejtori i drejtorisë.
3. Materialet duhet të përgatiten në pajtim me rregullativën ligjore, të lekturohen, si dhe sipas nevojës të dërgohen në zyrën ligjore, para se të dorëzohen në sekretari.
4. Drejtorët e drejtorive janë gjithashtu përgjegjës për përcjelljen dhe zbatimin me kohë të detyrave të përcaktuara me planet e tyre të punës, Planin e Punës së Kryetarit të Komunës dhe Planin e Punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2011.
5. Për zbatimin e kësaj urdhërese obligohen Drejtorët e Drejtorive dhe Sekretaria e KK-së.
6. Urdhëresa hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.
7. Me këtë urdhëresë njoftohen: Drejtorët e Drejtorive, Zyra Ligjore, Lektorit i Komunës dhe Arkivi i Sekretarisë.



Kryetari i Komunës

Xhafer Tahiri




REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI  
Kryetari

Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 dhe nenin 67 "g" të Statutit të Komunës, si dhe me qëllim të përmbushjes së obligimeve të komunës ndaj agjendës Evropiane të dala nga raporti i Ministrisë së Pushtetit Lokal, Kryetari i Komunës jep këtë:

URDHËRESË

1. Urdhërohen drejtorët e drejtorive si dhe udhëheqësit e zyrave komunale si në vijim: Drejtoria për Ekonomi Bujqësi Pylltari dhe Zhvillim Rural, Drejtoria për Buxhet dhe Financa, Drejtoria për Administratë, Drejtoria për Arsim, Zyra për Komunitete dhe Kthim, Zyra për Komunikim me Publikun dhe Zyra e Personelit, që të ndërmarrin veprime të duhura me qëllim të përmbushjes së obligimeve që dalin nga agjenda evropiane e që janë kompetencë dhe përgjegjësi e komunës për çështjet që kanë të bëjnë me:
  - 1.1 Hartimin e Planit për menaxhimin e tokave rurale - DEBPZHR,
  - 1.2 Funksonalizimin e Qendrës për promovim të bizneseve - DEBPZHR,
  - 1.3 Hartimin e master – Planit për rregullimin e tokës bujqësore - DEBPZHR,
  - 1.4 Ndarjen e buxhetit për mbrojtjen e komuniteteve pakicë - DBF,
  - 1.5 Modernizimin e mbledhjes së të hyrave të tatimit në pronë - DBF,
  - 1.6 Publikimin e të gjitha akteve të organeve të komunës në faqen zyrtare në gjuhët zyrtare, - ZKP,
  - 1.7 Organizimin e fushatës për regjistrim të komuniteteve RAE në komunë - ZKK,
  - 1.8 Funksonalizimin e bazës së të dhënave për zyrtarët komunal – ZP,
  - 1.9 Evidentimin e numrit të nxënësve të komuniteteve pakicë (RAE) cilët kanë braktisur shkollimin - DKA.
2. Drejtorët e Drejtorive përkatësisht udhëheqësit e zyrave të cekura nga nën-pikat 1-9 të pikës 1 të kësaj urdhërese do të bashkëpunojnë dhe koordinojnë aktivitetet e tyre me Zyrtarin për integritet evropiane të komunës me qëllim të raportimit për të dhënat që kërkohen në raportet periodike të cilat dërgohen në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal.
3. Urdhëresa hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.
4. Urdhëresa iu dërgohet: drejtorëve të drejtorive, udhëheqësve të zyrave të cekur në pikën 1 të së njëjtës, zyrtarit komunal për integritet evropiane dhe arkivit të sekretarisë.



Kryetari i Komunës

Xhafer Tahiri



REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI

Kryetari



Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, nenin 67 “f” dhe “g” të Statutit të Komunës si dhe propozimin e Drejtorisë për Kulturë Rini dhe Sport dt.22.03.2018, Kryetari i Komunës merr këtë:


V E N D I M  
PËR FORMIM TË KOMISIONIT

1. Formohet komisioni për shqyrtim të kërkesave për subvencionim të botimit të librave, në këtë përbërje:
  - 1.1 **Gëzim Saraçi** – Drejtor i QK. “Hasan Prishtina” në Vushtrri
  - 1.2 **Izet Miftari** – Udhëheqës i Bibliotekës “N. Frashëri” në Vushtrri
  - 1.3 **Ekrem Miftari** – Udhëheqës i Arkivit të Komunës në Vushtrri
2. Komisioni në fjalë duhet të bëjë vlerësimin e librave për të cilat kërkohet të subvencionohen nga buxheti i komunës – fondi për transfere dhe subvencione në kuadër të Drejtorisë për Kulturë Rini dhe Sport, sipas kërkesave që i adresohen komunës si dhe propozoj Drejtorisë për Kulturë Rini dhe Sport librat që meritojnë të subvencionohen.
3. Vendimi hyn ë fuqi në ditën e nënshkrimit.
4. Vendimi ju dërgohet: Drejtorisë për Kulturë Rini dhe Sport, Anëtarëve të Komisionit dhe Arkivit të Sekretarisë.



Kryetari i Komunës

Xhafer Tahiri



REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI


Kryetari



Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, nenin 67 "f" dhe "g" të Statutit të Komunës, Kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M  
PËR FORMIM TË KËSHILLIT ORGANIZATIV PËR ORGANIZIM TË PRITJES SË  
DELEGACIONIT TË IOWA NGA SHBA

1. Formohet këshilli organizativ për pritje të delegacionit të Iowa-s të SHBA-ve, në këtë përbërje:
  - 1.1 **Z. Besim Muzaqi**, kryesues i KO,
  - 1.2 **Z. Nasuf Aliu**, anëtar
  - 1.3 **Z. Afrim Namani**, anëtar
  - 1.4 **Znj. Fatmire Cecelia**, anëtare
  - 1.5 **Z. Sedat Rashica**, anëtar
  - 1.6 **Z. Shkelzen Xhaferi**, anëtar
2. Këshilli organizativ do të bëjë të gjitha përgatitjet e nevojshme për organizim të pritjes së delegacionit të Iowa-s të SHBA-ve i cili do të qëndroj në komunën tonë nga data 09 maj 2018. Në kuadër të përgatitjeve ky këshill do të përgatis gjithashtu agjendën e kësaj vizite të cilën së bashku me informatën për përgatitjet e bëra do të ia dorëzoj për aprovim në prag të vizitës, kryetarit të komunës.
3. Vendimi hyn ë fuqi në ditën e nënshkrimit.
4. Vendimi ju dërgohet: Anëtarëve të Këshillit Organizativ dhe Arkivit të Sekretarisë.



Kryetari i Komunës

Xhafer Tahiri



REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI


Kryetari



Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, nenin 67 "f" dhe "g" të Statutit të Komunës, Kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M  
PËR FORMIM TË KOMISIONIT

1. Formohet komisioni për pranim të poçeve elektrike, (mall i konfiskuar nga Doganat e Kosovës i cili i dedikohet Komunës së Vushtrrisë), në këtë përbërje:
  - 1.1 **Skender Oshlani** – Administratë
  - 1.2 **Selim Abazi** – Arsim
  - 1.3 **Liridon Hajrizi** - Shëndetësi
2. Komisioni në fjalë do të bëj pranimin e mallit në terminalin doganorë në Mitrovicë me datën 04 prill 2018. Z. Hajzer Berisha, Depoist në terminal do të jetë zyrtar kontaktues (045-198-164) për organizimin e procesit dorëzim - pranimit të mallit, i cili do të ju njoftoj për kohën e paraqitjes tuaj në terminalin doganorë.
3. Vendimi hyn ë fuqi në ditën e nënshkrimit.
4. Vendimi ju dërgohet: Anëtarëve të Komisionit dhe Arkivit të Sekretarisë.



Kryetari i Komunës

Xhafer Tahiri



REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO  
KOMUNA E VUSHTRRISË - OPŠTINA VUÇITRAN

02 Nr. / Br. 426-1/18

Nr. i fq. / Br. sh. -02-

Data: / Datum 28.03.2018

VUSHTRRI - VUÇITRAN



REPUBLICA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI  
Kryetari

Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr. 03/L-040, nenin 5 të Rregullores së MF Nr.04/2017 mbi kriteret standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, si dhe nenin 67 “g” të Statutit të Komunës, Kryetari i Komunës merr këtë:


#### VENDIM

#### PËR SHPALLJEN E THIRRJES PUBLIKE PËR MBËSHTETJE FINANCIARE PUBLIKE PËR PROJEKTE/PROGRAME TË ORGANIZATAVE JO-QEVERITARE

1. Për implementimin e thirrjes publike do të zbatohen dispozitat e rregullores mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve.
2. Mbështetja financiare publike për projektet/programet e OJQ-ve do të ofrohet nga Buxheti i Komunës së Vushtrrisë, kodi ekonomik nr. 21110 në kuadër të programit nr.85024.
3. Mjetet financiare do të shpërndahen në bazë thirrjes publike për financimin e projekteve të OJQ-ve, sipas dokumentacionit për zbatimin e thirrjes, e cila është pjesë përbërëse e këtij vendimi.
4. Dokumentacioni për zbatimin e thirrjes sipas pikës paraprake të këtij vendimi përfshinë:
  - 1.1 Teksti i thirrjes publike
  - 1.2 Udhëzimet për aplikantët
  - 1.3 Formularët e aplikimit
  - 1.4 Forma për vlerësimin e cilësisë së projekteve
  - 1.5 Format për raportimin e zbatimit të projektit
5. Formularët e aplikimit referuar në paragrafin 1 të këtij neni janë:
  - 1.1 Forma e përshkrimit të programit apo projektit
  - 1.2 Forma e buxhetit të programit apo projektit
  - 1.3 Forma e deklaratimit të mungesës së fondeve të dyfishta
  - 1.4 Deklaratat e Partneritetit (nëse është e aplikueshme)
  - 1.5 Forma e deklaratës së programeve apo projekteve të OJQ-ve të financuara nga burimet publike.



- 1.6 Deklarata për Aktivitetet e kontraktorit e përmendur në përshkrimin e aktiviteteve të projektit që janë të njohur me programin ose projektin dhe pjesëmarrjen e tyre në zbatimin (nëse aplikohet).
6. Formularët për zbatimin dhe raportimin e projekteve të referuara në paragrafin 1 të këtij neni janë:
- 1.1 Forma e kontratës për financimin e programit apo projektit
  - 1.2 Formulari për përgatitjen e raportit narrativ për projektin apo programin
  - 1.3 Formulari për përgatitjen e raportit financiar të programit apo projektit
7. Thirrja publike dhe dokumentacioni për zbatimin e thirrjes do të publikohen në mënyrë të plotë në faqen e internetit të ofruesit të burimeve financiare (web faqe).
8. Në përputhje me Rregulloren për kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik për OJQ-të dhe udhëzuesit për aplikantët, ofruesi i mbështetjes financiare publike do të krijojë një Komision Vlerësues për hapjen dhe regjistrimin e aplikacioneve si dhe verifikimin e kushteve të përcaktuara të thirrjes publike.
9. Komisioni vlerësues do të bëjë vlerësimin e përmbajtjes së aplikacioneve të projekteve të pranuar që kanë përmbushur me sukses kushtet formale për të qenë pjesë e konkurrimit sipas paragrafit 1 të këtij neni.
10. Anëtarët e Komisionit Vlerësues do të punojë në përputhje me procedurën e përcaktuar në Udhëzimet për aplikuesit dhe rregullat e parapara me rregulloren për financimin publik të OJQ-ve.
11. Pasi të merret vendimi mbi aplikuesit e suksesshëm, projektet e të cilëve i plotësojnë kushtet për financim, udhëheqësi i institucionit merr vendim për ndarjen e mjeteve për financimin e projekteve/ programeve të OJQ-ve.
12. Ofruesi i mbështetjes financiare do të njoftoj përfituesit për kohën e nënshkrimit të kontratave.
13. Përgjegjës për zbatimin e këtij vendimi është Drejtoria për Kulturë rini dhe Sport.
14. Vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.
15. Vendimi i dërgohet Drejtorisë për Kulturë rini dhe Sport dhe Arkivit të Sekretarisë.



Kryetari i Komunës

Xhafer Tahiri



REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLICA KOSOVO  
KOMUNA E VUSHTRRISË - OPËSTINA VUÇITRIN

02 Nr. / Br 426-2/18

Nr. i fq. / De. st -02-

Data: / Datum 28.03.2018

VUŠITRRI - VUÇITRIN



REPUBLICA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI  
Kryetari

Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr. 03/L-040, nenin 5 të Rregullores së MF Nr.04/2017 mbi kriteret standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, si dhe nenin 67 “g” të Statutit të Komunës, Kryetari i Komunës merr këtë:

#### VENDIM

#### PËR SHPALLJEN E THIRRJES PUBLIKE PËR MBËSHTETJE FINANCIARE PUBLIKE PËR PROJEKTE/PROGRAME TË ORGANIZATAVE JO-QEVERITARE

1. Për implementimin e thirrjes publike do të zbatohen dispozitat e rregullores mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve.
2. Mbështetja financiare publike për projektet/programet e OJQ-ve do të ofrohet nga Buxheti i Komunës së Vushtrrisë, kodi ekonomik 21110 në kuadër të programit 73033.
3. Mjetet financiare do të shpërndahen në bazë thirrjes publike për financimin e projekteve të OJQ-ve, sipas dokumentacionit për zbatimin e thirrjes, e cila është pjesë përbërëse e këtij vendimi.
4. Dokumentacioni për zbatimin e thirrjes sipas pikës paraprake të këtij vendimi përfshin:
  - 1.1 Teksti i thirrjes publike
  - 1.2 Udhëzimet për aplikantët
  - 1.3 Formularët e aplikimit
  - 1.4 Forma për vlerësimin e cilësisë së projekteve
  - 1.5 Format për raportimin e zbatimit të projektit
5. Formularët e aplikimit referuar në paragrafin 1 të këtij neni janë:
  - 1.1 Forma e përshkrimit të programit apo projektit
  - 1.2 Forma e buxhetit të programit apo projektit
  - 1.3 Forma e deklaramentit të mungesës së fondeve të dyfishta
  - 1.4 Deklaratat e Partneritetit (nëse është e aplikueshme)
  - 1.5 Forma e deklaratës së programeve apo projekteve të OJQ-ve të financuara nga burimet publike.

- 1.6 Deklarata për Aktivitetet e kontraktorit e përmendur në përshkrimin e aktiviteteve të projektit që janë të njohur me programin ose projektin dhe pjesëmarrjen e tyre në zbatimin (nëse aplikohet).
6. Formularët për zbatimin dhe raportimin e projekteve të referuara në paragrafin 1 të këtij neni janë:
- 1.1 Forma e kontratës për financimin e programit apo projektit
  - 1.2 Formulari për përgatitjen e raportit narrativ për projektin apo programin
  - 1.3 Formulari për përgatitjen e raportit financiar të programit apo projektit
7. Thirrja publike dhe dokumentacioni për zbatimin e thirrjes do të publikohen në mënyrë të plotë në faqen e internetit të ofruesit të burimeve financiare (web faqe).
8. Në përputhje me Rregulloren për kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik për OJQ-të dhe udhëzuesit për aplikantët, ofruesi i mbështetjes financiare publike do të krijojë një Komision Vlerësues për hapjen dhe regjistrimin e aplikacioneve si dhe verifikimin e kushteve të përcaktuara të thirrjes publike.
9. Komisioni vlerësues do të bëjë vlerësimin e përmbajtjes së aplikacioneve të projekteve të pranuar që kanë përmbushur me sukses kushtet formale për të qenë pjesë e konkurrimit sipas paragrafit 1 të këtij neni.
10. Anëtarët e Komisionit Vlerësues do të punojë në përputhje me procedurën e përcaktuar në Udhëzimet për aplikuesit dhe rregullat e parapara me rregulloren për financimin publik të OJQ-ve.
11. Pasi të merret vendimi mbi aplikuesit e suksesshëm, projektet e të cilëve i plotësojnë kushtet për financim, udhëheqësi i institucionit merr vendim për ndarjen e mjeteve për financimin e projekteve/programeve të OJQ-ve.
12. Ofruesi i mbështetjes financiare do të njoftoj përfituesit për kohën e nënshkrimit të kontratave.
13. Përgjegjës për zbatimin e këtij vendimi është Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale.
14. Vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.
15. Vendimi i dërgohet Drejtorisë për Shëndetësi Përkujdesje Sociale si dhe Arkivit të Sekretarisë.



Kryetari i Komunës

Xhafer Tahiri